

VENDIM
Nr.1643, datë 17.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË VLORË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vlorë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimor.	Në pronësi
46,48,50-56,58-61	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
44,45	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
99-103,118,122	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
79,83-87,151-153	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
116	Varrezat publike.	Në pronësi
104-115,117,119-121,123-150,645-823	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
74,154,504,576	Prona që përdoren për	Në pronësi

	ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	
155-471	Prona që përdoren në fushën e strehimit e mbrojtjes civile.	Në pronësi
626-628,630	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
629	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi